

VENDIM
Nr. 677, datë 29.7.2015

PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALIT “POÇEM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 8 (tetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “Çinar-San Hafriyat Nakliyat İnşaat Turizm Sanayi Ve Ticaret Limited Şirketi” për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Poçem”.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama